



Instituti i Kërkimeve Urbane

FLETË INFORMUESE MBI PROJEKTET

Instituti i Kërkimeve Urbane

Organizimi i eventeve publike për të rritur pjesëmarrjen e shoqërisë civile në mbështetjen e Reformës Administrative Territoriale

Konteksti i projektit

IKU nëpërmjet PNUD organizoi dhe drejtoi 12 konsultime me publikun në katër qarqet e vendit - Korçë, Elbasan, Tiranë dhe Durrës, për diskutimin e dy varianteve të konfigurimit të hartës së Shqipërisë (me 39 ose me 49 Zona Funksionale) të miratuara nga komisioni i posaçëm parlamentar në kuader të reformës administrative territoriale, në këndveshtrimin e implikimeve që kjo reforme do të ketë në shërbimet e ofruara, si dhe cilësinë e jetës së qytetareve në këto zona.

Pjesëmarrja në këto takime e shoqërisë civile dhe grupeve të tjera të interesuar ishte rreth 561 persona, nga të cilët 128 ose 23% ishin femra dhe 49 ose 9% ishin të rinj studentë të universiteteve të vendit.

Qëllimi i Projektit

Reforma administrative territoriale është një nismë kyç që ka si qëllim kryesor përmirësimin e shërbimeve publike dhe fuqizimin e qeverisjes lokale duke kontribuar në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të vendit. Kjo reforme do të fuqizojë qeveritë lokale dhe rajonale duke decentralizuar më shumë funksione dhe kompetenca dhe shpërndarjen e më shumë fondeve publike për ta. Njësitë e qeverisjes vendore më të mëdha do të kenë më shumë



mundësi për të marrë pjesë në projekte të bashkëpunimit ndërkombëtar; thithin më shumë fonde nga BE-ja dhe donatorë të tjerë; si dhe një hapësirë më të madhe për bashkëpunim ndër-komunal.

Objektivat kryesore

- Pjesëmarrjeje sa më e gjerë e shoqërisë civile dhe grupeve të interesuara në takimet konsultative për reformën.
- Arritja e një konsensusi në mesin e tyre për variantet më të mundshme të diskutuara nga komisioni i reformës, deri në procesin përfundimtar të vendimmarrjes.
- Ndryshimi i të kuptuarit nga politikëbërësit duke konsideruar gjendjen reale për shërbimet, zhvillimin ekonomik, financat lokale dhe faktorë të tjerë të rëndësishëm për reformën.

FAKTET KRYESORE

PARTNERET:

- ✓ UNDP

KOHËZGJATIA:

Mars 2014 - Gusht 2014

PËRFITUESIT:

- ✓ Qarku Tiranës
- ✓ Qarku Durrësit
- ✓ Qarku Korçës
- ✓ Qarku Elbasanit

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtoresh Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al
Web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.